

EC

MA NDRYSHE

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RICIKLO -



EKO KLUBI "REMZI ADEMAJ"

1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS

Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI

YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

EC ka filluar publikimin e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Gjimnazit "Remzi Ademaj" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimeve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).



Ambienti ku ne jetojmë, ndërton tek ne tiparet morale dhe psiqike. Formimi jonë është i lidhur ngusht me mjedisin ku ne jetojmë, pra në një formë ai përfaqëson vet njeriun. Nga mjedisi ne marrim të gjitha elemente e nevojshme për ekzistencë.

Natyra ne na ka falur shumë të mira, por si çdo gjëje tjetër ne nuk i'a dijmë vlerën deri në momentin kur e humbasim, e njëjta po ndodh edhe me mjedisin. Pak nga pak mjedisi po shkatërrohet nga ne dhe ne vet po cënojmë resurset tona.


Ta ruajmë mjedisin sepse ai është vet jeta!

Shpejtim Fazliu X6 - Eko Klubi
"Remzi Ademaj"

"MJEDISI MUND TË JETOJË PA NE, POR NE JO PA TË..."

Ambienti natyror është i domosdoshëm për zhvillimin e jetës në mirëqenie që njeriu t'i zhvillon veprimtaritë e tij njerëzore në atë zonë. Mjedi në disa vende të botës është bërë temë shqetësuese për shkak të disa faktorëve ekologjik por edhe faktorë negativ që njeriu i përhap në atë mjedi që gradualisht ajo zonë ndotet dhe mbetet e pa banuar jo vetëm nga njerëzit kafshët apo bimët por edhe gjithë botën organike dhe joorganike. Përndryshe mjedi i pastër është shumë i shëndetshëm dhe tepër produktiv si nga ana njerëzore, bimë dhe shtazore.

Valdrin Binaj X6 – Eko Klubi "Remzi Ademaj"



"MJEDISI , PËRMBUSHJA SHPIRTËRORE"



Në një mjedis në të cilin ka një rregull pastërtie, një rregull mirëmbajtje aty gjithmonë ka një përmbushje motivuese të duash edhe më shumë natyrën, atë të cilën ne rritemi dhe jetojmë me të gjitha peripecitë jetësore e kulturore. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm për atë vend në të cilin jetojmë , ta përmbushim me pasuri natyrore dhe të kemi një shëndet të mirë dhe të zhvilluar pastër. Në një natyrë të dëlirë gjithmonë do të kesh motiv për të qenë më kreativ në këndvështrimet e ndryshme jetësore. Dua të përmbledh se , natyra është pasuria më e madhe që e kemi dhuratë falas, e ne duhet të tregojmë edukatën tonë se sa jemi të vetëdijshëm të kujdesemi dhe ta mbrojmë atë. Jini bujar me natyrën, është vlera më e çmuar që posedojmë!


Dëbora Krasniqi X4 – Eko Klubi
"Remzi Ademaj"





AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:



TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE
EÇ MA NDRYSHE





DITA BOTËRORE E UJIT

Në Ditën Botërore të Ujit - 22 Marsi, Eko-Klubi zhvilloi një aktivitet senzibilizues me ç'rast nxënësit kanë vizituar kompaninë "Hidroregjioni Jugor" ku janë informuar për vlerat cilësore dhe sasiore të ujit të pijshëm në qytetin e Prizrenit.



EKO KLUBI "REMZI ADEMAJ"

RR. REMZI ADEMAJ, PRIZREN, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".